



REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SERVICE OF KOSOVO

Pranimar / Dorezuar Primijsno/Prodato Received/Delivered	06.11.2020	viti god year	2020
Organ /Njesia Organ /Jedinitca Org./Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKP/MACh.	2505/2020		1/5



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.280/2020

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave në përbërje nga: Ardita Haxhnikaj-Demi-kryetare, Arben Mehmeti dhe Eshref Shabani-anëtarë dhe Zyle Millaku Gojnovci-Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.280/2020 të datës 23.09.2020 të parashtruar nga ankuesi ██████████, përmes përfaqësuesit të autorizuar avokatit Refiz Shehu, me adresë rruga "Sali Ceku", P, në Ferizaj, në çështjen juridike "kompenzim material", kundër organit të punësimit Komuna e Ferizajt, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nënparagrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nënparagrafin 1.2 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 05.11.2020, mori këtë:

V E N D I M

- I. **Aprovohet** si e bazuar ankesa A.nr.280/2020 e datës 23.09.2020, e parashtruar nga ankuesi ██████████
- II. **Anulohet** Vendimi Nr.02-070/01-0063411/20 i datës 11.09.2020 i Komisionit për Zgjedhjen e Kontesetve dhe Ankesave i Komunës së Ferizajt,
- III. **Shfuqizohet** pjesërisht vendimi Nr.103/20 i datës 27.07.2020 i Kryetarit të Komunës.
- IV. **Obligohet** Kryetari i Komunës së Ferizajt, që brenda afatit prej 15 (pesëmbdhjetë) ditësh nga dita e pranimit të këtij vendimi, ankuesit ██████████ ti njeh të drejtën kompensimit të shumës së ndaluar prej 50% të pagës, nga data e vendimit për pezullim parandalues Nr.69/18 të datës 07.02.2018 deri në kthimin e tij sipas vendimit Nr.103/20 të datës 27.07.2020.
- V. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim.
- VI. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

A r s y e t i m

Ankuesi ██████████ në pozitën e Udhëheqësit të Zyrës Komunale për Komunitete në Kuvendin e Komunës së Ferizajit, me vendimin Nr.69/18 të datës 07.02.2018 të Kryetarit të Kumunës së Ferizajit për shkak të fillimit të hetimeve penale kundër tij, është pezulluar nga puna me pagesë prej 50 % të pagës së tij mujore, duke fillur nga data 08.02.2018 deri në marrjen e vendimit përfundimtar nga Gjykata.

Me Aktgjykimin PKR. Nr. 168/2017 të Gjykatës Themelore-Departamenti për Mitur në Ferizaj të datës 21.06.2019 i plotëfuqishëm nga data 13.01.2020, ankuesi është liruar nga aktakuza për shkak se nuk është vërtetuar se ka kryer vepër penale sipas aktakuzës Nr. PP./I.115/2017 të datës 30.10.2017. Pas aktgjykimit lirues, ankuesi me datë 02.06.2020 ka parashtruar kërkesë me nr.34748/20 te Komuna e Ferizajit për kthimin e tij në vendin e punës, duke kërkuar të gjitha të drejtat nga marrëdhënia e tij e punës, pasi që është shpallur i pafajshëm.

Kryetari i Komunës së Ferizaj, me vendimin 01 Nr.103 të datës 27.07.2020, ka aprovuar pjesërisht kërkesën e ankuesit, ashtu që ankuesin e kthen në vendin e punës Udhëheqës i Zyrës Komunale për Komunitete sipas Ndryshim- Plotësim të Aktit të Emërimit të datës 23.05.2017 duke filluar nga data 01.08.2020 , ndërsa ka refuzuar të drejtat tjera nga marrëdhënia e punës.

Ankuesi i pakënaqur me Vendimin 01 Nr.103/20 të datës 27.07.2020 të Kryetarit të Komunës, me datë 14.08.2020 ka parashtruar ankesë në Komisionin për Zgjedhjen e Kontesteve dhe të Ankesave të Komunës Ferizajit. Ky i fundit me datë 11.09.2020 me Vendimin Nr.02-070/01-0063411/20, refuzon ankesën e ankuesit dhe lënë në fuqi Vendimin 01 Nr.103/20 të datës 27.07.2020.

Ankuesi i pa kënaqur me vendimin e KZKA-së Nr.02-070/01-0063411/20 të datës 11.09.2020, përmes përfaqësuesit të autorizuar Avokatit Rafiz Shehu ka parashtruar ankesë me datë 23.09.2020 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës me numër protokolli 1878/2020, me pretendimet ankimore që të shfuqizohet vendimi i KZKA-së Nr.02-070/01-0063411/20 i datës 11.09.2020 dhe vendimi 01 Nr.103 të datës 27.07.2020 i Kryetarit të Komunës së Ferizajit, të detyrohet kabineti i Kryetarit që të nxjerr vendim të ri më të cilin ankuesit i njihet e drejta e realizimit të pagës prej 50% nga pezullimi parandalues deri me fillimin e punës me datë 01.08.2020, si dhe të gjitha të drejtat e tjera nga marrëdhënia e punës, trusti, pensional, stazhi i punë etj.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës me datën 25.09.2020, ka dërguar kërkesën për përgjigje në ankesë të Komuna e Ferizajit. Më datë 09.10.2020 Këshilli ka pranuar përgjigje në ankesë se bashku me shkresat përcjellëse.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, për marrjen e vendimit meritor ka administruar këto prova: Ankesën me numër protokolli 1878/2020 të datës 23.09.2020 e parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; autorizimi i datës 13.08.2020; Vendimin e datë 11.09.2020 të Komisionit për Zgjedhjen e Kontesteve dhe të Ankesave; Përgjigje ne ankesë e datës 09.10.2020; Vendimi 01Nr.69/18 i datës 07.02.2018; Vendimi me numër 01 Nr. 115/18 të datës 08.03.2018 i Kryetarit të Komunës; Aktgjykimin PKR,nr.168/2017 të Gjykatës Themelore-Departamenti për Mitur në Ferizaj të datës 21.06.2019; Aktgjykimin PAKR.nr.539/2019 të Gjykatës së Apelit-Departamenti për Mitur të datës 13.01.2020; Vendimi 01 Nr.103/20 të datës 27.07.2020; Formulari per kërkesë i datës 14.08.2020; Ankesa e datës 14.08.2020 për Komisioni për Zgjedhjen e Kontesteve dhe të Ankesave; Lista e pagës per muajin korrik; Kërkesë e datës 27.10.2020.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e lëndës të parashtruara nga palët, ka konstatuar së pretendimet ankimore të ankuesit janë të bazuara, sepse:

Kolegji, ka shqyrtuar pretendimet ankimore të ankuesit sipas ankesës nr.280/2020 të datës 23.09.2020 me te cilin kërkon që të shfuqizohet vendimi i KZKA-së Nr.02-070/01-0063411/20 i datës 11.09.2020 dhe vendimi 01 Nr.103 të datës 27.07.2020 i Kryetarit të Komunës së Ferizajt, të detyrohet kabineti i Kryetarit që të nxjerr vendim të ri më të cilin ankuesit i njihet e drejta e realizimit të pagës prej 50% nga pezullimi parandaluesi deri me fillimin e punës me datë 01.08.2020, si dhe të gjitha të drejtat e tjera nga marrëdhënia e punës, trusti, pensional, stazhi i punë etj.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, duke vlerësuar në pikëpamje të ligjshmerisë Vendimin e Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Komunë së Ferizajit Nr.02-070/01-0063411/20 të datës 11.09.2020, me të cilin është refuzuar ankesa e ankuesit dhe ka lënë në fuqi vendimin e Kryetarit të Ferizajit 01 Nr.103/2020 të datës 27.07.2020, ka konstatuar se KZAK-ja me rastin e nxjerrjes së këtij vendimi, nuk ka vërtetuar drejtë gjendjen faktike dhe gabimisht ka zbatuar dispozitat materiale të shërbimit civil. Arsyetimi i vendimit të KZAK-së nuk përmban të gjitha kërkesat ligjore sipas nenit 48 paragrafi 1 të Ligjit Nr. 05/L-031 Për Procedurën e Përgjithshme Administrative i cili përcakton: *Arsyetimi i siguron palës mundësinë që ta kuptojë aktin administrativ. Arsyetimi përmban:;1.2. shpjegimin e situatës faktike mbi të cilën është marrë vendimi; 1.3. shkaqet të cilat kanë qenë vendimtare gjatë vlerësimit të provave; 1.4. bazën ligjore të vendimit dhe arsyen pse është e zbatueshme në rastin konkret.....Një arsyetim që është dukshëm i pamjaftueshëm, i paqartë, kundërthënës apo i pakuptueshëm e është i barabartë me mungesën e tij.*

Bazuar në këtë konstatim, e në mbështetje të dispozitave ligjore të nenit 52 paragrafi 1 nën paragrafi 1.4 dhe 1.5 të Ligjit Nr.05/L/-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, akti administrativ i nxjerrë në kundërshtim me dispozitat që rregullojnë formën-elementet e detyrueshme të aktit administrativ apo është në kundërshtim me ligjin material konsiderohet akt i paligjshëm.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, bazuar në shqyrtimin e shkresave të lëndës ka konstatuar së Kryetari i Komunës së Ferizajt me vendimin 01 Nr.103 të datës 27.07.2020, ka vepruar në pajtim me Nenin 63 paragrafi 5 të Ligjit Nr.03/L-149 Për Shërbimin Civil të Republikës duke kthyer ankuesin në vendin e tij të punës ashtu siç përcaktohet me këtë nen*Nëse nëpunësi civil i akuzuar për kryerje të veprës penale shpallet i pafajshëm: 5.1. ai/ajo do të kthehet në vendin e punës dhe në dosje nuk do të përfshihet asnjë përmendje e procedurës penale dhe/ose pezullimit parandalues...* ndërsa refuzimi dhe mos njohja e së drejtës së kompensimit të pagës se ndaluar prej 50% nga data e vendimit për pezullim parandalues Nr.69/18 të datës 07.02.2018 deri në datën e kthimit në punë më 01.08.2020, është në kundërshtim më nenin 69 paragrafi 3 i Ligjit Nr.03/L-149 Për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës i cili parasheh: *Nëse nëpunësi përkatës civil më pas rikthehet në shërbim, qoftë për shkak se akuza kundër tij/saj nuk ka mundur të dëshmohet, për shkak të dyshimit ose arsyeve të tjera teknike, ai/ajo duhet të konsiderohet se është pezulluar nga ushtrimi i detyrës. Periudha e mungesës do të trajtohet si periudhë e qëndrimit në detyrë për të gjitha qëllimet dhe nëpunësi civil duhet të marrë rrogën e plotë dhe mëditjet të cilat ai/ajo do t'i kishte marrë nëse nuk do të ishte pezulluar nga shërbimi'. Në kuptim të këtyre dispozitave ligjore, Kryetari i Komunës së Ferizajt, me rastin e nxjerrës së vendimit për kthim në punë të ankuesit pas aktgjykimit lirues PKR. Nr. 168/2017 të Gjykatës Themelore-Departamenti për Mitur në Ferizaj të datës 21.06.2019, është dashur ti njohë ankuesit edhe të drejtën e kompensimit të 50 % të pagës së ndaluar nga data e vendimit për pezullim parandalues deri në datën e kthimit të tij në punë.*

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, bazuar në nenin 83 paragrafi 9 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtaret Publik, vlerëson së procedura e pezullimit parandaluese nga puna me pagesë prej 50% të pagës mujore është zhvilluar sipas Ligjit Nr. 03/L-149 Për Shërbimin Civil, dhe ka vazhduar sipas dispozitave të atij ligji.

Nga ajo që u tha me lartë, bazuar në nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafi 1. 2 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës si dhe nenin 132 paragrafi 4 të Ligjit Nr./L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Kolegji vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Në rast të moszbatimit të vendimit të Këshillit nga personi përgjegjës i organit të punësimit, Kryetari i Këshillit ndërmerr veprimet në pajtim me nenin 21, 23 dhe 24 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duke aplikuar edhe ndalimin e 50 % të pagës mujore për personin përgjegjës, deri në zbatimin e vendimit të Këshillit.

Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi, pala e pakënaqur mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalin ekzekutimin e këtij vendimi.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës
Lënda me numër A.nr.280/2020

Zyle Millaku Gajnovci

Zyle Millaku Gajnovci
Procesmbajtëse

Ardita Haxhnikaj - Demi

Ardita Haxhnikaj - Demi
Kryetare e Kolegjit



Vendimi i dërgohet:

- Përfaqsesit/Avokatit Rafiz Shehu;
- Kryetarit të Komunës së Ferizajt;
- Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore të Komunës së Ferizajt dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.3

